



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT**

Nr. 260/12 Prot.

Tiranë, më 29/04/2021

**V E N D I M**

**Nr.54, Datë 29/04/2021**

**PËR**

**AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR NË DREJTORINË VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS SARANDË, ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS PËRMET, ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS MALLAKASTËR DHE ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS MIRDITË, “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”**

Nga auditimet e ushtruara në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim DVASHK) Sarandë, Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ZVASHK) Përmet, ZVASHK Mallakastër dhe ZVASHK Mirditë, rezultoi që janë rekomanduar gjithsej 249 masa, nga të cilat janë pranuar 176 masa ose 71%, si dhe nuk janë pranuar 73 masa ose 29%. Nga rekomandimet rezultoi se janë zbatuar plotësisht 116 masa ose 47%, zbatuar pjesërisht/proces 47 masa ose 19%, 46 masa të pa zbatuara ose 18%, si dhe 20 masa ose 8% të ezazuara si pasojë e ndryshimeve ligjore etj. Niveli i zbatimit të rekomandimeve nuk është i plotë, kështu nga 191 masa organizative, nuk janë pranuar 22 rekomandime ose 12% e tyre dhe janë pranuar 169 masa organizative ose 88%, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 102 masa ose 60% e tyre, janë zbatuar pjesërisht/proces zbatimi 46 masa ose 27%, dhe nuk janë zbatuar 14 masa ose 8% e tyre. Në lidhje me masat për shpërblim dëmi është rekomanduar 1 masë shpërblim dëmi në vlerën 5,436,194 lekë, e cila nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar. Në lidhje me masat për të ardhura të munguara janë lënë 19 rekomandime për arkëtimin e detyrimeve për të ardhura të munguara në vlerën totale 1,006,552,428 lekë, nga të cilat janë pranuar 18 rekomandime në vlerën 1,003,009,302 lekë ose 96% e tyre, si dhe nuk është pranuar vetëm 1 masë në vlerën 3,543,126 lekë ose rreth 4% e tyre. Nga masat e pranuar janë arkëtuar në total 65,518,933 lekë.

Në përfundim të auditimeve nga KLSH janë lënë 38 masa disiplinore, nga të cilat nuk është zbatuar asnjë prej tyre ose 100%. Në përfundim kemi konkluduar se veprimtaria e subjekteve të audituara, në drejtim të çështjeve që lidhen me zbatimin e rekomandimeve, nuk ka qenë plotësisht efektive.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

## VENDOSA

**I.** Të miratoj Raportet Përfundimtare të Auditimit “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2020”, të ushtruar në 4 subjektet e audituara.

**II.** Të rikërkoj marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve për të gjitha subjektet e audituara, si më poshtë:

### **NË DREJTORINË VENDORE TË AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS, SARANDË**

#### **A. MBI REKOMANDIMET E PAPERANUARA**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të kryer pranë 4 subjekteve të auditimit, u konstatua se në subjektin DVASHK Sarandë, nuk janë pranuar 24 rekomandime, për të cilat gjykojmë se duhet të rivlerësohen me objektivitet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, masat e rekomanduara, efekti që sjellin, dhe problematika që limiton zbatimin e tyre.

#### **B. MASA ORGANIZATIVE**

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 902/8 prot., datë 22.05.2020, nuk janë zbatuar rekomandimet si vijon:

-Rekomandim nr.1.1: Drejtoria Vendore e ASHK Sarandë, për nevoja të plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me leje legalizimit të lëshuara, t'i kërkojë Bashkive Sarandë, Himarë, Finiq dhe Konispol, vërtetimet mbi llogaritjen dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej 804,249,039 lekë, si dhe të kërkojë që të bëhet regjistrimi në sektorin përkatës të kartelës në Drejtorinë Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, në refuzim të vendosen masa për kufizimin deri në arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara.

-Rekomandim nr.5.1: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë:

1. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, për objektet informale të pajisura me leje legalizimi në rastet si më lart në kundërshtim, me dispozitat e ligjit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, dhe të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit.

2. Për pasuritë e regjistruar sipas lejeve legalizimi konstatuar të lëshuara me shkëlqe në raste e mësipërme të marrë masa në bazë të nenit 27 pika 1 e 4 të ligjit 111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” të nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

Të marrë masa dhe të vendoset masa kufizimi për këto pasuri deri në rikthimin e ligjshmërisë për këto pasuri.

-Rekomandim nr.6.1: Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sarandë, të marrin masa për plotësimin e dosjes me dokumentacionin e kërkuar ligjor për objektin informale të pajisur me leje legalizimi si më lart.

Rekomandim nr.8.1: Rekomandimi: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë bazuar në nenin 27, pika 1 e 4, të ligjit nr.111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të kërkojë nga subjekti plotësimin e dosjes së lejes së legalizimit me akt-ekspertizës për qëndrueshmërinë e objekti, në të kundërt në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK Tiranë, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit duke nxjerrë urdhër kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor.

-Rekomandim nr.10.1: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të marrë masa dhe të rivlerësojë gjendjen juridike të pronave për subjektet: nr.2968 E. M. A.; nr.02555 G. M. A.; nr.02554 K. V. M. dhe A. K. M.; nr.02557 Xh. A. O., nr.02564 A. N. M., nr.02566 N. H. Sh., nr.02596 P. M. T., nr.02586 K. Th. A., nr.02578 A. S. P., nr.02567 P. Sh. D., nr.02761 E. R. D., nr.02747 F. M. O., nr.02749 E. M. K., nr.02699 I. N. H. dhe E. N. H., nr.02714 N. S. V., nr.02710 Sh. S. M., nr.02704 E. A. R., nr.2833 D. Q. D., nr.02553 I. B. I., nr.02562 E. I. D. dhe Z.

I. A., nr.02609 A. Ll. S., nr.02709 Xh. H. D., , nr.2746 A. S. R., nr.2647 K. V. L., nr.02674 H. Y. I., nr.02682 H. P. I., nr.02651 S. B. M., nr.02659 E. F. G., nr. 02660 F. M. Z. dhe të veprojë me përgjegjësi duke rikthyer ligjshmërinë e tyre.

Rekomandim nr.10.2: Për të ardhmen të mos kryhen regjistrime si akte administrative, (përfshirë leje legalizimi) për objektet informale, në kushtet e mosrespektimit të PPV të miratuar dhe të Zonës së Mbrojtur të miratuar me akte ligjore e nënligjore.

-Rekomandim nr.11.1: Drejtoria Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, bazuar në nenin 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, duke vendosur kufizimin për pasuritë e regjistruar sipas referencave nr.1713 ; nr.1699 ; nr.1700 ; nr.1702 ; nr.1703 ; nr.1689 ; nr. 1626 ; nr.2006 ; nr.2055 ; nr.01595 ; nr.01594 ; nr.01571 ; nr.01601 ; nr.01600 ; nr.1580, deri në shqyrtimin dhe rivlerësimin edhe një herë nga sektori i legalizimit, të dokumentacionit tekniko ligjor, mbi bazën e të cilit janë lëshuar 15 lejet e legalizimit, duke njoftuar subjektet për fillimin e procedurave përkatëse sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”.

-Rekomandim nr.27.1: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Sarandë, të marrë masë për plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe evidentimin e pagesës mbi shlyerjen e detyrimeve pranë Bashkisë Sarandë.

-Rekomandim nr.28.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor si dhe Preventivin sipas lejes së ndërtimit dhe situacioni përfundimtar, për të llogaritur diferencën e taksës së infrastrukturës nga ajo e paguar në Bashki dhe rikthimin e ligjshmërisë.

-Rekomandim nr.29.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor, si Lejen e ndërtimi për ndërtim të përkohshëm si dhe Praktikës të bashkëngjitet Akti i vlerësimit dhe procesverbali të piketimit të truallit dhe rikthimin e ligjshmërisë.

-Rekomandim nr.30.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi për pasuritë e trajtuara në gjetjen nr.30.

-Rekomandim nr.34.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi të vendosë masë kufizimi deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë, duke njoftuar subjektin B. K. për vendosjen e masë kufizimit dhe pas kalimit të afatit ligjor 30 ditor të kryejë regjistrimin e pronës në favor të qytetarit K. Th. K.

-Rekomandim nr.35.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi për pasurinë e regjistruar sipas referencës nr.18018, ZK 8641, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë.

-Rekomandim nr.38.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, në zbatim të nenit 27, të Ligjit nr.111, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën” të marrë masa për vendosjen e masës së kufizimit për:

- pasuritë nr.14/168 vol 22 fq 174 me qëllim kryerjen e veprimeve korigjuese nga nocioni I në nocionin F, certifikatës familjare;

- pasurinë nr.14/169 vol 22 fq 175, për diferencën në sipërfaqen e llojit “Truall” në masën 10 m<sup>2</sup>; kufizim për pasurinë 3/347/nd në volumin nr.22 fq 22, me qëllim kryerjen e veprimeve përkatëse në seksionin B (përfshirjen e truallit në KPP), regjistrimin e kësaj pasurie me nocionin F, referuar certifikatës familjare, si dhe vendosjen e hipotekës ligjore në favor të DVASHK Sarandë në seksionin E për parcelën ndërtimore që do të miratohet me VKM;

- pasurinë nr.14/169 vol 22 fq 184 me sipërfaqe 462 m<sup>2</sup> në pronësi shtet, në pasurinë nr.14/170 vol 22 fq 185 me sipërfaqe 73 m<sup>2</sup> në pronësi shtet, në pasurinë nr.14/172 vol 22 fq 187 me sipërfaqe 135 m<sup>2</sup> në pronësi shtet, si dhe në pasurinë nr.14/173 vol 22 fq 188 me sipërfaqe 448 m<sup>2</sup> në pronësi të P. B., me qëllim kryerjen e veprimeve përkatëse për sistemimin e diferencës së sipërfaqes prej 74 m<sup>2</sup>, si dhe regjistrimin e pasurisë së legalizuar me lejen e legalizimit nr.62415 me nocionin F,

referuar certifikatës familjare deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor të kërkuar dhe rikthimin e ligjshmërisë .

-Rekomandim nr.40.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë, të marrë masa: për evidentimin e 1252 praktikave në proces, kohëzgjatjen nga aplikimi, evidentimin e problematikave, krijimin e mbajtjes së evidencës së praktikave në proces, si dhe të marrë masa për inventarizimin e dokumentacionit për 1252 praktikat në proces e të pa përfunduara.

-Rekomandim nr.41.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, për regjistrimin hipotekor të lejes së legalizimit nr. 45569, datë 21.05. 2013, në përputhje e zbatim të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006”Për legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, si dhe nenit 53 të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”.

-Rekomandim nr.45.1: Nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të merren masa: Për zbatimin e Vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 152, datë 16.03.2019 “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 20-2018-30/16 datë 16.01.2018 i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë”, për heqjen e sekuestrove konservative të vendosura sipas kërkesës me nr.1349 prot datë 16.02.2018 nga Zyra Përmbartimore “B.-K”; Si dhe për vazhdimin regjistrimi i pasurive që rrjedhin nga pasuria nr. 18/77 nd, në përputhje e zbatim të dokumentacionit ligjor të paraqitur për regjistrim dhe rikthimin e ligjshmërisë.

-Rekomandim nr.46.1: Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë të marrë masa që në bashkëpunim me Bashkinë Sarandë të kërkojë në mënyrë zyrtare (me shkresë) për përcaktimin e saktë të gjurmës së objektit (të legalizuar e shkualifikuar) me lejen nr. 1042826, datë 31.07.2019 “Godinë me funksion social-ekonomik me 2 kate”, dhe saktësimin e statusit tekniko juridik në lidhje me zonën C.2. Bredenesh Sarandë për të përcaktuar cënimin ose jo të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë miratuar Vendimin e KKT nr. 3, datë 16.10.2017. Me marrjen e shkresës të procedojë me rikthimin e ligjshmërisë të kësaj leje legalizimi (*Më hollësisht trajtuar në faqe 13-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, për rastet e evidentuara më sipër, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve.

**Deri më datë 31.08.2021**

### **C. MASA SHPËRBLIM DËMI EKONOMIK**

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 902/8 prot., datë 22.05.2020, nuk janë zbatuar rekomandimet si vijon:

-Rekomandim nr.1.1: Nga Titullari i DVASHK Sarandë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 5,436,194 lekë, të ardhura të munguara me efekt dëm ekonomik, të krijuara nga mos llogaritjet e sakta të tatimit dhe taksës së kalimit të të drejtave mbi pronën (*Më hollësisht trajtuar në faqe 25-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, të marrë masat e nevojshme për të ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës 5,436,194 lekë.

**Deri më datë 31.08.2021**

### **D. TË ARDHURA TË MUNGUARA**

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 902/8 prot., datë 22.05.2020, nuk janë zbatuar rekomandimet si vijon:

-Rekomandim nr.4.1: Drejtori i Drejtorisë Vendore të ASHK Sarandë të marrë masa, që në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, të vendosë masë kufizimi deri në administrimin e dokumentacionit të pagesës së diferencës së truallit në vlefhtë prej 3,543,126 leke dhe të ndjekë në rrugë ligjore arkëtimin e taksës së kalimit të pronësisë në shumën 531,469 lekë.

-Rekomandim nr.5.1: Drejtoria Vendore e ASHK Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore deri në daljen e VKM-ve, për 16 dosje të objekteve informale të pajisur me Leje legalizimi të objektit, për të mundësuar brenda afateve ligjore likuidimin të vleftës të parcelave ndërtimore prej 19,158,879 lekë, si e ardhur e munguar për Buxhetin e shtetit dhe fondin e kompensimit të ish-pronarëve (*Më hollësisht trajtuar në faqe 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore në favor të përfituesve të lejeve të legalizimit, për të mundësuar likuidimin e vlerës së parcelave ndërtimore në vlerën 19,158,879 lekë.

**Deri më datë 31.08.2021**

## **E. MASA DISIPLINORE**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 902/8 prot., datë 22.05.2020, nuk është zbatuar rekomandimi, për dhënien masave disiplinore për punonjësit, si vijon:

### **a. Masa “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” (zgjidhje kontrate)”, për 7 punonjës si më poshtë:**

1. E. L., në cilësinë e ish-Përgjegjës Sektori, aktualisht specialist,
2. E. L., në cilësinë e ish-Përgjegjës Sektori, aktualisht specialist,
3. V. T., në cilësinë e specialistes Juriste,
4. B. D., në cilësinë e specialistit Hartograf,
5. K. K., në cilësinë e specialistit Jurist,
6. L. H. në cilësinë e specialistit Hartograf,
7. M. H., në cilësinë e specialistit të financës.

### **Masa disiplinore “Vërejtje” për 7 punonjës si më poshtë:**

1. M. L. në cilësinë Specialiste Terreni
2. V. L. në cilësinë Specialist Terreni
3. Xh. T. në cilësinë specialiste Terreni
4. D. H. në cilësinë specialiste Terreni
5. J. L., në cilësinë e specialistit jurist.
6. L. K., në cilësinë e specialistit Jurist,
7. O. G., në cilësinë e Pritëse Populli.

Për sa më sipër, për moszbatimin e rekomandimit, për dhënien e masave disiplinore punonjësve të mësipërm, mbështetur në Kreu IV, neni 11 gërma “d” dhe “e”, nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për veprime në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në bazë të nenit 9, pika 2, gërma ç e Ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe në kontratat individuale të punës, i rikërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më sipër dhe marrjen e masave disiplinore.

## NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, PËRMET

### A. MASA DISIPLINORE

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.901/14 prot, datë 19.05.2020, nuk është zbatuar rekomandimi, për dhënien e masës disiplinore për punonjësit, si vijon:

#### Për ZVASHK Përmet

“Vërejtje me shkrim”, për

1. z. G. I., me detyrë Përgjegjës i Sek. të Hartografisë,
2. z. P. L., Specialist Hartograf.

#### Për ALUIZNI Gjirokastër

“Largim nga puna” për

1. Znj. A. K., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Hartografisë.

Për sa më sipër, për moszbatimin e rekomandimit, për dhënien e masave disiplinore punonjësve të mësipër, mbështetur në nenin 15, shkronja “c” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", si dhe në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në kontratën individuale të punës **i rikërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më sipër dhe marrjen e masave disiplinore.

## NË DREJTORINË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, MALLAKASTËR

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 903/9, datë 20.5.2020, janë në proces zbatimi rekomandimet si vijon:

**-2.2. Rekomandim:** DVASHK Fier (për ish-ZVRPP Mallakastër) të marrë masa të rishqyrtojë për kthimin e ligjshmërisë aplikimin nr. 361, datë 13.2.2017 sipas referencës nr. 0116, datë 11.8.2016, si dhe të bëjë bilancin dhe duke argumentuar regjistrimet për 13 pasuri me sipërfaqen 44550 m<sup>2</sup> kullotë ndërsa sipas VKKP nr. 19 datë 22.7.1999 shprehet kthimi i sipërfaqes prej 46900 m<sup>2</sup>.

**-3.1. Rekomandim:** DVASHK Fier (për ish-ZVRPP Mallakastër), të marrë masa të kryejë inventarizimin me emërtimet përkatëse të dokumenteve, me numrat progresiv rritës për secilin dhe për praktiken në tërësi.

**-5.1. Rekomandim:** DVASHK Fier (për ish-ZVRPP Mallakastër) të marrë masa të argumentojë diferencën prej 3191 m<sup>2</sup> (10632 m<sup>2</sup>-7141 m<sup>2</sup>) rezultuar ndërmjet AMTP dhe LN si dhe të identifikojë e çelë KPP-të përkatëse për 2 pasuri të llojit ullishte me sipërfaqe 6800 m<sup>2</sup> duke futur në sistem e hequr bashkëpronësinë për pasuritë e llojit ullishte të keqmenaxhuar nga NJMP gjatë procesit të menaxhimit për futjen në Sistemin e Regjistrimit Fillestar (SRF) të ZK. zk. 2869 Panahor.

**-6.1. Rekomandim:** DVASHK Fier (për ish-ZVRPP Mallakastër) të marrë masa të informojë Bashkinë Mallakastër për vënien nën administrim dhe verë në dispozicion gjendjen juridike për 2 KPP-të e çelura të 2 pasurive me sipërfaqe 728 m<sup>2</sup> arë, regjistruar “shtet” përkatësisht: pasuria v. 7, f. 241, zk. 2369 Panahor me sipërfaqe 108 m<sup>2</sup> arë, pasuria v. 7, f. 242 zk. 2369 Panahor me sipërfaqe 620 m<sup>2</sup> arë, si dhe të shënojë në seksionin “D” të KPP-ve “Shtet” poseduesin e pasurisë me shënimin: “Kjo pasuri posedohet nga X.Y”.

**-7.1. Rekomandim:** DVASHK Fier (për ish-ZVRPP Mallakastër) të marrë masa të identifikojë e çelë KPP-të përkatëse për 4 pasuri të llojit ullishte me sipërfaqe 5800 m<sup>2</sup> duke futur në sistem sipas sipërfaqeve përcaktuar në AMTP nr. 4609, datë 5.8.95 dhe të heq bashkëpronësinë e paligjshme për pasuritë e llojit ullishte, veprime rrjedhur nga keqmenaxhimi i bërë prej NJMP gjatë procesit të menaxhimit për futjen në Sistemin e Regjistrimit Fillestar (SRF) të ZK. zk. 2869 Panahor.

**-8.1. Rekomandim:** DVASHK Fier (për sh-ZVRPP Mallakastër) të marrë masa të informojë Bashkinë Mallakastër për vënien nën administrim dhe në dispozicion gjendjen juridike për 1 KPP-të çelura të pasurisë me sipërfaqe 2125 m<sup>2</sup> arë, regjistruar “shtet” përkatësisht: pasuria nr. 106/90, v. 7, f. 239, zk. 2869 Panahor arë 2125 m<sup>2</sup> si dhe të shënojë në seksionin “D” të KPP-ve “Shtet” poseduesin e pasurisë me shënimin: “Kjo pasuri posedohet nga “X.Y”.

**-9.1. Rekomandim:** DVASHK Fier (për sh-ZVRPP Mallakastër) të marrë masa të identifikojë e çelë KPP-të përkatëse për 1 pasuri të llojit ullishte me sipërfaqe 2800 m<sup>2</sup> duke futur në sistem dhe të heq bashkëpronësinë e paligjshme për pasurinë e llojit ullishte, veprime rrjedhur nga keqmenaxhimi bërë prej NJMP gjatë procesit të menaxhimit për futjen në Sistemin e Regjistrimit Fillestar (SRF) të ZK. zk. 2869 Panahor.

**-10.1. Rekomandim:** DVASHK Fier Mallakastër (ish-ZVRPP Mallakastër), Drejtori të marrë masa të bëjë bilancin hap pas hapi dhe në vazhdimësi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive tokë bujqësore të veçojë e regjistrojë “Shtet” sipërfaqet e tepërta mbi normë; si dhe të informojë zyrtarisht me shkresë rastin e lidhur me gjendjen e KPP-ve, ku përmbi 171 kryefamiljarë ndodhur në ZK 2869 Panahor që zotërojnë rreth 340 pasuri tokë bujqësore me sipërfaqe tepër mbi +55 3593 m<sup>2</sup>, ose 55,3 ha për të cilat nuk është bërë bilanci (AMTP-LN-PIII) sipas KPP të çelura, si dhe për 58 Kryefamiljarë ndodhur në ZK 3191 Romës që zotërojnë rreth 140 pasuri tokë bujqësore me sipërfaqe tepër mbi +108 919 m<sup>2</sup>, ose 10,9 ha për të cilat nuk është bërë bilanci (AMTP-LN-PIII) sipas KPP të çelura; që kanë sjellë si pasojë prej vitesh deformimin e pagesës së detyrimit të taksës së tokës; me synim plotësimin e detyrimeve të ndërsjella në vazhdimin e procedurave përcaktuar nga VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të AMTP”.

**-13.1. Rekomandim:** DVASHK Fier (ish-ZVRPP Mallakastër) Drejtori në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Tiranë të marrë masa të futë në sistemin e menaxhimit të regjistrimit fillestar të pasurive në ZK. 2869 Panahor dhe ZK. 3191 Romës, të identifikojë pasuritë me sipërfaqet përkatëse të llojit ullishte përfituar sipas AMTP-ve që u përkasin KPP-ve çelura në bashkëpronësi të paligjshme përkatësisht 25 pasuri me sipërfaqe 1 845 042 m<sup>2</sup> ose 184,5ha të llojit ullishtë ndarë 20 pasuri me 1 357 558 m<sup>2</sup> ose 135,7 ha në ZK 2869 fshati Panahor dhe 5 pasuri me 487484 m<sup>2</sup> ose 48,7 ha ZK. 3191 Romës, bashkëpronësi e paligjshme që ka sjellë si pasojë mos regjistrimin dhe pamundësinë e regjistrimit, si dhe ritme të ngadalta regjistrimi të pasurive të paluajtshme bujqësore të llojit ullishtë.

**-14.1. Rekomandim:** Drejtoria Vendore e Kadastrës (Fier), zyra Mallakastër në bazë të nenit 27 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, për shkeljet konstatuara, të verifikojë vlefshmërinë e AMTP të ZK 2715 Mollaj, duke plotësuar dokumentacion tekniko-ligjor të rregullt dhe më tej të kryejë sistemit dhe transaksionet sipas përkatësisë.

**-27.1. Rekomandim:** Zyra e kadastrës Mallakastër (Drejtoria Vendore Fier) në bazë të nenit 27 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, për shkeljet konstatuara: të kalojë “shtet” sipërfaqen tepër 127 m<sup>2</sup> “arë”, diferencë AMTP - LN, ZK 3180, Riban, përkatësisht: sipërfaqja 41 m<sup>2</sup>, pasuria nr. 201, vol. 1, faqe 245 dhe sipërfaqja 86 m<sup>2</sup>, pasuria nr. 435/1, vol 3, faqe 16.

**-29.1. Rekomandim:** DVASHK Fier (për ish-ZVRPP Mallakastër) të marrë masa për rimenaxhimin e zonave kadastrale 1945-Hekal, 1438- Damës dhe 2270-Kremanar, duke kryer veprimet e pasqyrit dhe çeljes së KPP-ve për pasuritë e llojit ullishtë mbështetur në sipërfaqet e përcaktuara

në AMTP, sipas normës ligjore dhe sikundër përcakton Ligji Nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën” i ndryshuar.

**-30.1. Rekomandim:** Për referencat e mësipërme DVASHK Fier (për ish-ZVRPP Mallakastër) të informojë Bashkinë Mallakastër për vënien e pasurive të çelura nën administrim dhe juridiksionin e bashkisë, si dhe të shënojë në seksionin “D” të KPP-së “Shtet” poseduesin e pasurisë.

**-32.1. Rekomandim:** Zyra Vendore e ASHK Mallkastër, Drejtori të marrë masa për të bërë një rakordim të dytë me Bashkinë Mallakastër për rikonfirmimin e ndryshimeve të bëra, sipas sipërfaqes së çdo pasurie të dhënë me AMTP në të kundërt të vendosë urdhër kufizimi për pasurinë Nr. 118/5 si dhe të rikthejë në gjendje fillestare pasurinë shtet të natyrës “arë” nr. 118/4 vol. 12, fq. 24 zk 1945 Hekal për sipërfaqen 931 m<sup>2</sup>.

**-33.1. Rekomandim:** DVASHK Fier (për ish-ZVRPP Mallakastër) të marrë masa për vendosjen e kufizimit mbi pasuritë nr. 548/1, vol. 5, fq. 214 dhe nr 106/3, vol.5, fq.218 si dhe të bëjë veçimin e sipërfaqes tepër dhe çeljen e karteleve të pasurisë shtet për sip. 244m<sup>2</sup> dhe 112 m<sup>2</sup> nga pasuritë respektive.

**-34.1. Rekomandim:** DVASHK Fier (për ish-ZVRPP Mallakastër) të vendos kufizim për pasurinë nr. 68/1 dhe të marrë masa për veçimin e sipërfaqes tepër dhe çeljen e kartelës për pasurinë shtet me sip. 90m<sup>2</sup> nga pasuria nr. 68/1, vol. 7, fq, 227 zk: 1945 Hekal-fshat.

**-35.1. Rekomandim:** DVASHK Fier dhe ASHK Tiranë në bashkëpunim me Bashkinë Mallakastër të marrin masa të identifikojnë dhe regjistrojnë e vënë në administrim 12 fusha sporti me sipërfaqe 83070 m<sup>2</sup>, të saktësojnë 7 KPP e çelura duke eliminuar sipërfaqen mangët prej -19516 m<sup>2</sup>, të çelin 3 KPP me sipërfaqe 23000 m<sup>2</sup> që i përkasin 3 ZK-ve të futura në sistem dhe të pa çelura KPP përkatësisht 3000 m<sup>2</sup> fusha ZK. 1401 Cfir, 15 000 m<sup>2</sup> fusha zk. 2715 Fshati Mollaj dhe 5000m<sup>2</sup> fusha zk. 2076 fshati Kapaj; si dhe të futin në sistemin e Menaxhimit të Regjistrimit Fillestar dhe të identifikojnë 2 fusha sporti me sipërfaqe 7435 m<sup>2</sup> përkatësisht 3500 m<sup>2</sup> fusha e fshatit Drizarë zk. 1555 dhe 3935 m<sup>2</sup> fusha e fshatit Kute zk. 2350, pasqyruar në tabelën emërtuar” Mbi gjendjen e KPP-ve të çelura nga NJMP dhe Regjistri i Pasurive Fusha Sporti transferuar me VKM nr. 458 Date, 26.07.2018 për Bashkinë Mallakastër.

**-36.1. Rekomandim:** DVASHK Fier dhe ASHK Tiranë (për ish-ZVRPP Mallakastër) në bashkëpunim me Bashkinë Mallakastër të marrin masa të identifikojnë dhe regjistrojnë e vënë në administrim 15 rezervuar, 5 Stacione Pompimi, të saktësojnë 11 KPP çelura kundrejt 15 total, të identifikojnë e çelin KPP-të për 4 rezervuar përkatësisht; Visokë 1, Visokë 2 zk. 3789, Gjenoqarë zona të pa futur në sistem dhe Rezervuari Cycen zk. 1424 i cili nuk është identifikuar megjithëse zona është në sistem; të saktësojnë, identifikojnë veçojnë e çelin KPP për 3 Stacione pompimi si: Visoka 1, Visoka 2 zk. 3789, dhe Stacioni Kute zk. 2350, zona të pa futura në sistem dhe të çelin identifikojnë pasuritë e KPP-ve për aksesoret përkatës pra të pasurive lidhur me 303 km kanale të para dhe 278 km kanale të dyta.

**-37.1. Rekomandim:** DVASHK Fier dhe ASHK Tiranë (për ish-ZVRPP Mallakastër) në bashkëpunim me Bashkinë Mallakastër të marrin masa të identifikojnë dhe regjistrojnë e vënë në administrim pasuritë që i përkasin 10 ujësjellësve “Sisteme të furnizimit me ujë” konkretisht: të identifikojnë e pasqyrojnë në mënyrë të rregullt, pasuritë përkatëse truall, depo uji, ndërtesa e aksesore për 2 ujësjellës (ujësjellësi Bejar pasqyruar në mënyrë të parregullt ne pasurinë nr. 260, v.6, f. 104 zk. 1135 e llojit Ullishte me sipërfaqe totale 57190 m<sup>2</sup> duke mos identifikuar pasuritë truall ndërtesë, depo uji dhe Ujësjellësi Hekal pasqyruar në mënyrë të parregullt ne pasurinë nr. 94/4, v. 10, f. 217 zk. 1945 e llojit Kullotë); gjithashtu të merren masa të identifikohen pasuritë përkatëse truall, ndërtesa, depo uji e aksesore, e të çelin e KPP-të për 4 ujësjellës renditur; ujësjellësi Aranitas ZK. 1027, zonë në sistem dhe 3 ujësjellës si; ujësjellësi Kutë zk. 2350, ujësjellësi Drenovë zk. 1539 dhe ujësjellësi Lapulec zk. 2384, ndodhur në tri këto zona të pa futura në sistem.

**-38.1. Rekomandim:** DVASHK Fier (për ish-ZVRPP Mallakastër), të marrë masa të inventarizojnë e rakordojnë listën për 4 vjet 2016-2019 për zonën e Ballshit të rreth 673 dosje leje legalizimi të përfunduara e të dërguara për regjistrim, ndërsa ZVRPP Mallakastër dokumenton 570 dosje prej të cilave 294 dosje të regjistruara dhe 276 dosje të kthyer, si dhe të sqarojnë mosrakordimin prej 103 dosje legalizimi ndërmjet dy institucioneve pasi ALUIZNI Fier si dhe gjithashtu të



identifikojnë e rakordojnë shlyerjen e detyrimeve të taksës ndikimit në infrastrukturë dhe të ardhurën e munguar.

**-39.1. Rekomandim:** DVASHK Fier (Për ish-ZVRPP Mallakastër) Drejtori të marrë masa dhe të vendosë kufizim për 16 pasuri përkatësisht: Pasuritë nr. 8/367-N, v. 23, f. 10 zk. 1090 Ballsh, pas 1/151,v. 22, f. 177 ZK 1090 Ballsh pas 8/365,v. 22, f. 241 ZK 1090 Ballsh, pas 9/326,v. 22, f. 220 ZK 1090 Ballsh, pas 10/229, v. 22,f. 216 ZK 1090 Ballsh, pas 216/1, v. 7,f. 177 zk 2270 Kremenar, pas 216/3, v. 7,f. 180 zk 2270 Kremenar, pas 89/8,v. 12, f. 199, zk 1027 Aranitas, nr. 3/261-N, v. 23, f. 169, c. 2.10 zk. 1090 Ballsh, pas nr. 1/155, v. 23, f. 104 zk. 1090 Ballsh, pas nr. 8/146-n1, n2, n3, n4, n5, v. 23, f. 177-182 ZK 1090 Ballsh, pas 5/147, v. 23, f. 88, zk. 1090 Ballsh, pas 10/232, v. 23, f. 28 zk. 1090 Ballsh, pas. nr. 10/251, v. 23, f. 239 zk. 1090 Ballsh, pas nr. 14/131-ND v. 23, f. 195 ZK 1090 Ballsh, pas nr. 106/67, v. 2, f. 195 zk. 1424 Çyçen, deri në likuidimin e taksës ndikimit në infrastrukturë ne vlerën prej 710525 lekë për sipërfaqen 4452,8 m<sup>2</sup> dhe për mosvendosjen e kufizimit në seksionin “E” të KPP-ve për shkak të moszgjidhjes në marrëdhënies me truallit përkatës të sipërfaqes së parcelës ndërtimore, pasqyruar në tabelën emërtuar “Regjistrime leje legalizimin pagesa e taksës infra, origjina e parcelës ndërtimore veprimet ne KPP”.

**-57.1. Rekomandim:** DVASHK Fier për (Ish-ZVRPP Mallakastër, Regjistruesi të marre masat për inventarizimin e dokumentacionit, dhe të evadohen aplikimet e 54 praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara prej vitesh deri ne 31.12.2019, të analizohen dhe kthehen të ardhurat e përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar përkatësisht 378 mijë lekë, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ish-ZVRPP Mallakastër ndaj publikut; si dhe të administrohen në arkivë dokumentacioni përkatës i praktikave, sipas tabelës “Praktikat e prapambetura të administruara në ZVRPP Mallakastër të pa Trajtuara Fare ose me aktverifikimi prej para Vitet 2016- 31.12.2019”.

**-57.2. Rekomandim:** DVASHK Fier (Ish-ZVRPP Mallakastër) dhe ASHK Tiranë të marrin masa të hartojnë Rregulloren përkatëse “Për Punën në Zyrat Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës“, në përmbushje të Funksioneve dhe detyrave të përcaktuar nga ligji nr.111/2018 “Për Kadastrën” si dhe të hartojë “Rregulloren përkatëse të funksionimit të Administratës të DVASHK Fier Mallakastër”, duke mbajtur parasysh përfshirjen dhe instalimin e Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) në përmbushje të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, lidhur me administrimin e dokumentacionit në tërësi dhe veçanërisht të administrimit të praktikave dhe aplikimeve me AV dhe në proces, të qytetarëve (*Më hollësisht trajtuar në faqe 13-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** ZVASHK Mallakastër dhe DVASHK Fier në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, për rekomandimet e evidentuara më sipër, që janë në proces zbatimi, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

**Në vazhdimësi**

## **B. TË ARDHURA TË MUNGUARA**

**1.1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 903/9, datë 20.5.2020, janë në proces zbatimi rekomandimet si vijon:

-1.1. Rekomandim: DVASHK Fier (Për ish-ALUIZNI Fier zona Mallakastër) të marrë masa në ndjekje të ecurisë së procesit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, të daljes së VKM-së për kalimin e pronësisë dhe shpronësimit e ish-pronarëve përkatës deri në likuidimin e vlerës së parcelës ndërtimore 15,536,300 lekë si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit (*Më hollësisht trajtuar në faqe 53-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** DVASHK Fier në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, të marrin masa për vazhdimin e procesit të kalimit në pronësi të parcelave ndërtimore për objektet e legalizuara dhe arkëtimin e vlerës së palikuiduar.

**Në vazhdimësi**

## **C. MASA DISIPLINORE**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 902/8 prot., datë 22.05.2020, nuk është zbatuar rekomandimi, për dhënien masave disiplinore për punonjësit, si vijon:

### **I. Për punonjësit e ish-ZVRPP (ZVASHK) Mallakastër**

#### **I- Masa “Vërejtje me paralajmërim” për 2 punonjës si më poshtë:**

1. Për E. Xh., me detyrë
2. Për J. M., me detyrë Përgjegjës.

### **II. Për punonjësit e ish-ALUIZNI-t Fier, zona Mallakastër**

#### **I- Masa “Vërejtje” për 15 punonjës si më poshtë:**

1. A. Dh., me detyrë specialist,
2. H. S., me detyrë specialist,
3. A. R., me detyrë specialist,
4. E. G., me detyrë specialist,
5. F. Ç., me detyrë specialist,
6. S. K., me detyrë specialiste,
7. A. T., me detyrë specialiste,
8. L. M., me detyrë specialist,
9. A. N., me detyrë specialist,
10. D. P., me detyrë specialist,
11. A. B., me detyrë specialist,
12. I. Ll., me detyrë specialist,
13. S. A., me detyrë Specialist,
14. E. Ç., me detyrë specialist,
15. K. M., me detyrë specialist.

Për sa më sipër, për moszbatimin e rekomandimit, për dhënien e masave disiplinore punonjësve të mësipërm, mbështetur në Kreu IV, neni 11 gërma “d” dhe “e”, nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për veprime në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në bazë të nenit 9, pika 2, gërma ç e Ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe në kontratat individuale të punës, i rikërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më sipër dhe marrjen e masave disiplinore.

## **NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, MIRDITË**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr.900/8, datë 19.05.2020, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

-Rekomandim 2: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marre masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të bëjë të diferencën dokument–fakt, duke kaluar në pronësi shtet sipërfaqen e tepërt prej 1037 m<sup>2</sup>, në kundërt të vendoset kufizim deri në eliminimin e shkeljeve të konstatuara për pasuritë: volum 7, faqe 204, pasuria nr. 6/29, truall me sipërfaqe 9191 m<sup>2</sup>, e cila mbyllet ndahet në

volum 8, faqe 78-80 dhe volum 7, faqe 205, pasuria nr. 6/59, truall me sipërfaqe 7272 m<sup>2</sup>, e cila mbyllet e ndahet në volum 8, faqe 81-83.

-Rekomandim 4: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara sipas: AMTP-së nr. 85, referencë nr. 0617, AMTP-së nr. 88, referencë nr. 615, AMTP-së nr. 123, datë 06.07.2004, referencë nr. 0603, referencë nr. 669, AMTP-së nr. 123, datë 06.07.1993, referencë nr. 580, AMTP-së nr. 61, referencë nr. 632, AMTP-së nr. 62, referencë nr. 0655, ZK 1666, deri në veçimin e regjistrimit në pronësi “shtet”, të sipërfaqes së përfutur padrejtësisht, në zbatim të procedurave të përcaktuara në VKM nr. 994, datë 9.12.2015 i ndryshuar.

-Rekomandim 7: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e përfutur me AMTP nr. 60, datë 01.02.2002, me posedues D. R., ZK 1666, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

-Rekomandim 12: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë, të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të marrë masa për saktësimin e sipërfaqeve të pasurive të regjistruara, evidentuara në pasqyrën në pasqyrën nr. 1, më parë se të kryhen transaksione sipas AMTP nr. 20(105) dhe referencës nr. 0039, AMTP 53 -54, AMTP 95 dhe referencës 0092, AMTP 2 dhe referencës 079, AMTP 72 dhe referencës 087, AMTP 66 dhe referencës 086, AMTP 7, AMTP nr. 114 dhe referencës 0191, AMTP 94 dhe sipas AMTP 93, bazuar në VKM nr. 994, datë 09.12.2015.

-Rekomandim 13: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë, të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, sipas LN, të evidentuara në pasqyrën nr. 1, për 9 raste me sipërfaqe total 10441 m<sup>2</sup>, përkatësisht sipas AMTP 95 nga P. D. B. 800 m<sup>2</sup>, sipas AMTP 66 nga N. D. T. 222 m<sup>2</sup>, sipas AMTP 7 nga M. Gj. P. 1339 m<sup>2</sup>, sipas AMTP 6 1081 m<sup>2</sup>, sipas AMTP 114 dhe ref. 0191 nga N. Gj. B. 272 m<sup>2</sup>, sipas AMTP 94, nga F. Ll. B. 946 m<sup>2</sup>, sipas referencës nr. 0074 nga P. Gj. M. 1441 m<sup>2</sup>, sipas AMTP nr. 55-dhe 64 nga B. N. P. për diferencën e përfutur sipas LN për 574 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqen 1201 m<sup>2</sup> përfutur me AMTP 64, dhe sipas referencës 0072 nga Gj. P. Gj. për sipërfaqen 2565 m<sup>2</sup> përfutur me LN dhe jo sipas dokumentacioni t ligjor AMTP, deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor për pasuritë.

-Rekomandim 44: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë të përfutur me leje legalizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit dhe miratimin e kalimit të pronësisë me VKM dhe vendosjen e marrëdhënieve me truallin përkatës.

-Rekomandim 48: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në 11 raste, të regjistruara sipas referencave përkatëse, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

-Rekomandim 50: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në 8 raste, të regjistruara sipas referencave përkatëse, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe deri në arkëtimin e detyrimit financiar nga 8 subjektet në vlerën 2,800,000 lekë (*Më hollësisht trajtuar në faqe 7-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** ZVASHK Mirditë në bashkëpunim me DVASHK Lezhë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, për rekomandimet e pazbatuara të marrin masa për zbatimin e tyre, ndërsa për rekomandimet e evidentuara që janë zbatuar pjesërisht apo në proces zbatimi, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

## **B. MASA DISIPLINORE**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.900/8, datë 19.05.2020, nuk janë zbatuar rekomandimet, për dhënien e masave disiplinore ndaj 2 punonjësve, si vijon:

**a. “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, për:**

1. J. P., me detyrë Përgjegjës.

**b. “Vërejtje me shkrim”, për:**

1. E. M., me detyrë specialist.

Për sa më sipër, për moszbatimin e rekomandimit, për dhënien e masave disiplinore punonjësve të mësipërm, mbështetur në nenin 15, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç” të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr.136/2015, Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës, i rikërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mësipërm.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Administrimit të Aseteve dhe Mjedisit dhe Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë.

---

**KRYETAR**

**Arben SHEHU**